

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "PROGRAMIM"

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1.Cili nga operatorët logjikë në python kthen **true** nëse një ka kushtet është i gabuar? **1 pikë**

- A) Or
- B) Not
- C) And
- D) In

2.Cila nga komandat më poshtë shërben për modifikimin e të dhënave të një tabele në një bazë të dhënash? **1 pikë**

- A) Update
- B) Modify
- C) Insert
- D) Select

3.Cila nga metodat e mëposhtme kthen gjatësinë e stringut në c#? **1 pikë**

- A) ToUpper()
- B) ToLower()
- C) Length
- D) Concat()

4.Cili nga formatet e mëposhtme të dizenjimit dhe zhvillimit grafikë nuk duhet t'i jepet klientit? **1 pikë**

- A) .png
- B) .psd
- C) .gif
- D) .jpg

5.Cilën nga alternativat afishon kodi i mëposhtëm në java për varablin **numri**? **1 pikë**

```
public class Main {  
    public static void main(String[] args) {  
        int numri = 15;  
        numri=25;  
        numri=20;  
        System.out.println(numri);  
    }  
}
```

- A) 15
- B) 25
- C) 15 25 20
- D) 20

6.Cila nga shprehjet SQL, shfaq emrin dhe id e studentit me id n-101 dhe notë mesatare 8.5, referuar tabelës si më poshtë? **1 pikë**

## Student

n-id	n-emër	n-mesatare
101	EEEE	8.5
102	FFFF	9.2

- A)SELECT AVG(n-id) FROM Student,n-mesatare  
 B)SELECT SUM(\*) FROM Student where n-id = " 101"and n-mesatare =8.5;  
 C)SELECT MAX (n-id) FROM Student where n-id = 101 or n-mesatare=8.5;  
 D)SELECT \* FROM Student where n-id = 101 and n-mesatare=8.5;

7.Cila nga programet e mëposhtme përdoret për dizenjimin e aplikacioneve? **1 pikë**

- A) Figma  
 B) Wordpress  
 C) Joomla  
 D) eclipse

8.Cila është alternativa e saktë për : System.out.println(x % y) nëse int x = 5 dhe int y = 2? **1 pikë**

- A) 5  
 B) 2  
 C) 0  
 D) 1

9.Cila nga alternativat e mëposhtme konsiderohet si gjuha e manipulimit të të dhënave ? **1 pikë**

- A) DDL  
 B) DBMS  
 C) DML  
 D) SQL

10.Cilën nga alternativat paraqet kodi i mëposhtëm në java? **1 pikë**

```
public static void main(String[] args) {
    for (int i = 0; i < 10; i++) {
        if (i == 4) {
            break;}
        System.out.println(i);}
}
```

- A) 0 1 2 3  
 B) 0 1 2 3 4  
 C) 1 2 3 4  
 D) 1 2 3

11. Cila nga alternativat e mëposhtme qëndron për përkufizimin : Një proporcion "i barabartë" në lidhje me simetrimin dhe asimetrimin quhet? 1 pikë

- A) shkalla (scale)
- B) uniteti (unity)
- C) balanca(balance)
- D) ritëm (rhythm)

12. Cilin nga tipet e mëposhtme të të dhënave, do të përdorim për të deklaruar atributin me emrin "datëlindje", në një tabel në një bazë të dhënash? 1 pikë

- A) string
- B) date
- C) varchar
- D) integer

13. Cilët janë operatorët assignment (assignment operators) në C#? 1 pikë

- A) =, +=, -=, \*=, /=, %=, &=, ^=, >>=, <<=
- B) +, -, \*, /, %
- C) !, &&, ||
- D) >, <, >=, <=, !=

14. Cila nga komandat e mëposhtme realizon grupimin e rekordeve, në një bazë të dhënash? 1 pikë

- A) Having
- B) Group BY
- C) Sort
- D) Order BY

15. Cila është sintaksa e saktë e përcaktimit të strukturës if në gjuhën c#? 1 pikë

- A) if (condition) { // block of code }
- B) if condition { // block of code }
- C) if (condition)
- D) if ((condition) ){ // block of code }

16. Cila nga alternativat e mëposhtme, **nuk** është funksion agregatë? 1 pikë

- A) MIN()
- B) MAX()
- C) EXISTS()
- D) AVG()

17. Cili nga elementet e vektorit afshohet në kodin e mëposhtëm ?

1 pikë

```
static void Main(string[] args)
{
    int [] numrat = {2, 3, 6, 7, 8};
    Console.WriteLine(numrat[3]);
}
```

- A) 2
- B) 3
- C) 7
- D) 8

18. Në cilin prej operatorëve relacional, tabelat bashkohen sipas attributeve të përbashkëta?

1 pikë

- A) Intersect
- B) Difference
- C) Natural Join
- D) Union

19. Cila nga shprehjet SQL, përdoret për të numëruar vlera të rreshtave në një tabelë?

1 pikë

- A) SELECT COUNT ()
- B) SELECT UNION
- C) SELECT DISTINCT
- D) SELECT INTERSECT

20. Cila është vlera që afishon System.out.println(a > 3 && a < 10) nëse int a = 5?

1 pikë

- A) 10
- B) 3
- C) True
- D) False

21. Bazuar në tabelën e dhënë më poshtë, shkruani sintaksën në SQL, e cila përzgjedh nga tabela id e nxënësve me moshë mesatare 16 vjeç dhe rendit nxënësit sipas mbiemrit.

4 pikë

#### Nxënësist

n_id	n_emër	n_mbiemer	n_mosha	email
13	Andi	Alla	16	aaaaa
14	Armarildo	Aliu	18	bbbbbb

22. Përcaktoni tipet e të dhënave (data type) që afishon kodi në python?

4 pikë

```
a = 7
b = 8.5
c = 3j
d = -145
print(type(a))
print(type(b))
print(type(c))
print(type(d))
```

23. Listoni katër nga parimet e dizenjimit të ndërfaqes së përdoruesit?

4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

24. Shkruani kodin në c#, i cili përdor metodën Concat() për bashkimin e dy stringjeve si: emrin dhe mbiemrin e studentit?

4 pikë

25. Listoni më poshtë katër nga funksionet e sistemit të menaxhimit të një baze të dhënash DBMS?

4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

26. Ndërtoni vektorin në java me emrin **Lendet\_profesionale**, i cili afishon elementet : web, programim, rrjeta, database?

4 pikë

27. Listoni katër nga hapat e zhvillimit të një procesi projektimit UX/UI?

4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

---

28.Ndërtoni metodën **Veprime** në java, e cila llogarit shumën e dy parametrave: **numer1**, **numer2** me vlera 20 dhe 25 ? 4 pikë

29.Listoni më poshtë katër komandat e gjuhës DDL duke specifikuar funksionin e tyre . 4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

30.Ndërtoni klasën **Programim** në c# me variabla **lenda** dhe **viti**, e cila afishon nëpërmjet objektit **Program1** vlerat inicializuese të variablave: **Java** dhe **2023**? 4 pikë

